



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.147/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ramush Bardiqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.147/2025 e datës 23.01.2025 paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët

A r s y e t i m

Me datë 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se më datë 21 janar 2025 asistenti i zyrës Administrative të Lëvizjes Vetëvendosje, Qendra në Sharr, Komuna e Dragashit, z.Asri Qusaj, ka postuar në rrjetin social facebook, i njëjti përdor gjuhë fyese dhe denigruese partive kundërshtare, konkretisht i njëjti në këtë postim ka deklaruar se: “M’u qu në saba dhe me i thonë vetes: “Bravo, Asri, je milioner, krejt punët i ke në terezi”-është njafarë motivimi momental, që ndoshta më lumturon e më jep pozitivitet, Por mbaron gjithçka, kur veç kthehmi në tjetrin krah. E njëjtë po më duken edhe këto takime fashat më fshat të partive LyDyKy e PyDyKy . Bartin njerëz nga fshatra të tjerë, vetëm sa për numër, sa për t’u motivuar e për t’u lumturu pak. Por këta as anën s’po e ndërrojnë-veç sytë po i mbledhin”. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se në veprimet e z.Asri Qusaj janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, të përcaktuar në nenin 34, par.1 nën par.1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe përmes përdorimit të gjuhës fyese dhe denigruese z.Asri Qusaj, PDK ka në ankesë ka konsideruar se janë tejkaluar kushtet që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit e cila për pasojë ka denigrimin dhe përkeqësimin e klimës në të cilën, duhet të zhvillohet gara zgjedhore dhe mund të rrisë tensione mes subjekteve politike. Ankuesi ne ankesë i është referuar praktikës se PZAP, vendimit A.nr.59/2025, të datës 20.01.2025.

Si provë ka bashkangjitur postimin e z.Asri Qusaj në rrjetin social facebook.

Më datë 24.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 25.01.2025 subjekti politik LVV e mohon shkeljen e bërë dhe thekson se ky status është vështirë të kualifikohet si aktivitet i fushatës zgjedhore pasi që statusi në fjale nuk ka ndonjë element identifikues vëzhgues të subjektit politik LVV dhe me këtë status nuk shihet as moto e fushatës e as e as ndonjë lidhje mes statusit të LVV dhe shkeljes së pretenduar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga fotografitë e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lart.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.147/2025 më datë 25.01.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardhi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.